



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1105/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Agneta Bytyqi kandidate për asamblenë komunale në Gjakovë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Agneta Bytyqi kandidate për asamblenë komunale në Gjakovë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),

**URDHËROHET** KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimet 0202C/4R, 0210 /4R dhe 0221C/2D dhe ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Gjydhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

#### **A R S Y E T I M**

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Agneta Bytyqi kandidate për asamblenë komunale në Gjakovë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se me rastin e numërimit të votave në VV 0202C/4R, 0210 /4R dhe 0221C/2D në Komunën e Gjakovës është bërë tjetërsimi dhe mos numërimi i votës brenda partisë përkatësisht listës së kandidatëve të LDK-së, me çrast nuk iu janë procesuar as vota e saj e as e familjarëve, pra rezultati sipas QNR-KQZ ajo ka 0 vota.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe dëshmit e ofruara është vërejtur se ka pasur parregullsi gjatë plotësimit të formularit sepse në të nuk figurojnë votat e kandidates në fjalë, andaj urdhërojmë që të bëhet rinumërimi në këtë VV. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më

qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A nr. 1105/2013 më datën 06.12.2013.



**Këshillë Juridik:**

*Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i*